

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rreth darvinizmit leksikor
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/rreth-darvinizmit-leksikor-i588270
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 08:40:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 08:34:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a50295971d0cc2107806ec793a1348aa281ecb3f84d698adf49726cbf7dbec70
TEKSTI	2dd9fb489d7066ad5546ab25355bddae2610b718c1633edfbb9a8004133555a7
PAMJA	51a274adb8ea407414c59eec89ef3a74b5b4aa233e17d0e286fdc04a3b19d021

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ddff9ac0bbaa3abbad2d73969aed12f2759f992f1322f0aa3a41923b6fa368ae
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdf651dfbc0b1533
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ddff9ac0bbaa3abbad2d73969aed12f2759f992f1322f0aa3a41923b6fa368ae>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



1 e Franca dergon ushtare ne Arabine Saudite, Macron: Do te mbrojme portin strategjik te nattes VIDEO/ "Europa ka shume per te mesuar nga bota," Rama nga SHBA: Paqja fundit

Rreth darvinizmit leksikor



25 Shtator 2026, 10:34Kulturë Ardian Vehbiu

Leksikologjia historike veç do të përfitonte nga adoptimi i një modeli darvinian, evolucionar, të llojit “survival of the fittest” – për të shpjeguar dinamikën e marrëdhënieve mes fjalëve dhe arsytet pse disa fjalë dalin nga përdorimi dhe disa të tjera hyjnë në përdorim rishtas.

Një fjalë përshtatet më mirë nëse i kryen punë më mirë përdoruesit të saj; nga ana tjetër, çdo fjalë ka edhe vullnetin a *shtysën (drive)* për të mbijetuar, falë inercisë; gjë që i ka rrënjët në bindjen – ose edhe shpresën – e përdoruesit se tjetri do ta njohë fjalën që ai përdor. Vetëm se fjala nuk mbijeton si instancë përdorimi ose okurrencë, qoftë e folur (*verba volant*), qoftë e shkruar; por nëpërmjet replikimit.

Në rastin e turqizmeve të shqipes, një pjesë e madhe e tyre ishin të dënuara të dilnin nga qarkullimi, sepse i referoheshin një bote sociale, së cilës kolektiviteti shqiptar po i largohej. Arsytet këtu ishin më shumë historike, se mirëfilli linguistike. Për ta thënë me Xhevat Lloshin: “Po të mos largohej *kadiu* real osman, as fjala nuk do të largohej ndonjëherë.”^[1] Në fakt, në luftën për ekzistencë me neologjizmat *gjyqtar* a *gjykatës*, *kjo kadi* do të kish avantazhin e rrënjës në përdorim, ose të inercisë. Ishte tkurrja dhe zhdukja e institucionit specifik osman, që ia këndoi dënimin me vdekje.

Nga ana tjetër, edhe “lufta” e fjalëve mes tyre për ekzistencë është dukuri kulturore, dhe jo vetëm sepse ndodh në mendjet e folësve dhe orienton zgjedhjet e tyre leksikore. Për një kulturë refleksive do të ishte e kushtueshme, madje e shpërdorueshme, që të lejonte humbjen e fjalëve dhe varfërimin leksikor, qoftë edhe për arsye mirëfilli leksik-evolucionare. Më mirë do të ishte sikur fjalët e skartuara, fjalët e skartueshme, dhe ato objektivist të dënuara me tkurrje dhe largim nga përdorimi, të adoptoheshin nga stile dhe regjistra specifikë.

Ashtu disa turqizma filluan të përdoren për të ngjyrosur leksikalisht letërsinë me temë historike – duke sjellë në tekst elemente që i referohen drejtpërdrejt botës osmane; teksa disa turqizma të tjerë u vunë në punë për të qesëndisur e përqeshur prapambetjen e një shtrese të popullsisë ende besnike ndaj një mënyre jetese të kapërcyer. Për të dy këto përshtatje stilistike, ishte e nevojshme që përdoruesit ta kishin zhvilluar tashmë “shqisën” e dallimit të turqizmeve si kategori leksikore më vete. Me gjasë, një çetë operatorësh kulturorë shpresonin edhe se, duke i shënjuar turqizmat në këtë mënyrë dhe duke nxitur aktivisht degradimin e tyre stilistik, do të ndihmonin edhe për ta distancuar kulturën dhe botën shqiptare nga e kaluara osmane; duke vazhduar, si me thënë, edhe në politikat gjuhësore dhe stilistike, luftën “për çlirim” nga Perandoria Osmane. Me kohë, kjo luftë “çlirimtare” do t’i humbte lidhjet e arsyeshme me realitetin social dhe politik, duke u kthyer ajo vetë në institucion kulturor kokëfortë.

Por shqipja filloi t’i përshtatë turqizmat edhe në mënyrë jo-reflekse, kur i orientoi drejt regjistrit bisedor, duke ua modifikuar, sipas nevojave të veta praktike, deri edhe kuptimet që kishin pasur në zanafillë. Po sjell vetëm një shembull, për të ilustruar se çfarë ndodhi.

Fjala **hiç** ka krijuar një hapësirë të vetën atje ku leksiku rrethprietet me gramatikën – meqë kjo fjalë, apo fjalëz nëse duam, merr tani pjesë në shprehjen gramatikore të mohimit në gjuhë.

Në kuptimin e vet si emër, *hiç* do të thotë “asgjë”, siç del edhe në dialogun elementar:

(Gjetët gjë? *Një hiç të madh gjetëm.*)

Por edhe në shprehjen *ti je një hiç*. Kam përshtypjen se e kam parë të përdoret edhe në kuptimin filozofik të asgjësë, *hiçi* (angl. *nothingless*, fr. *néant*), por do të ketë qenë më shumë ndonjë eksperiment autori.

Megjithatë, përdorimet më interesante të *hiç* i ndesh në bashkëvajtje me morfema të tjera mohuese. Kështu, dialogun e mësipërm mund ta rishkruanim:

Çfarë gjete? Asgjë, hiç. (Hiç, asgjë)

Dhe këtu nuk themi dot më se *hiç* ka thjesht kuptim mohor.

Përkundrazi, duket i ngjashëm, për nga kuptimi, me pjesëza përforcuese të mohimit, të tilla si *fare* dhe *aspak*.

Nuk fjeta dot *hiç* (Nuk fjeta dot *fare*)

Ti nuk më do *hiç*, më duket (Ti nuk më do *fare*, më duket)

Unë fol, ai hiç (sërish e alternueshme me *fare*).

Ndryshe nga *fare*, e cila përdoret si përforcuese edhe në fjali pohore (e paske qarë *fare*), ky lloj *hiç*-i ndeshet veç në ndërtime mohore.

Të gjitha këto përdorime të *hiç* janë bisedore – në shqipen librore ose formale, *hiç* nuk gjen dot vend, përveçse si fjalë “e shenjuar”. Dhe kjo është gjë e mirë – sepse dallimi midis një regjistri bisedor dhe një regjistri formal veç mund ta pasurojë shqipen në momentin e tanishëm.

Ka edhe prirje të kësaj fjalëze për t’u përdorur në mënyrën si u drejtohem fëmijëve:

Hiç nuk më pëlqen kjo që ke bërë!

Të shau ajo, vërtet? *Hiç* mos i fol më me gojë!

E kështu me radhë. Kjo ndodh ngaqë të folurit me fëmijët e kërkon teprinë (redondancën), dhe *hiç* në ndërtime mohore është zakonisht redondante.

Përndryshe, *hiç* hyn mes grupit të fjalëve më të përdorura në shqipen bisedore, ngaqë ka zënë vend në formulën standard të përsëritjes mes miqve:

Ç’kemi? *Hiç*, ç’të kemi? [ose]

Ç’kemi? *Hiç*, asgjë me rëndësi. Të zakonshmet.

Të vërehet edhe forma më e thjeshtë:

Në këto ndërtime, *hiç* specializohet për të zbutur impaktin e pyetjes, në atë lloj komunikimi që e kanë quajtur *fatik* (Malinoëski, Jakobson; ndryshe edhe *grooming speech* ose *small talk*), dhe që synon mirëmbajtjen e kanalit dhe ruajtjen e kontaktit.^[2]

Këtu *hiç* është e ndërkëmbyeshme me *asgjë* (por mund të përdoren edhe të dyja bashkë: *hiç, asgjë*; ose *hiç, jo ndonjë gjë të madhe*).

Nga ana tjetër, larmia e përdorimeve si këto më poshtë:

Hiç mos ia jep, le të ta kërkojë.

Hiç, mos m’u lut kot, nuk ta jap.

E bën *hiç* një pjesëz me sintaksë shumë fluide dhe me kuptim më shumë përforcues të mohimit në bashkëvajtje me morfema të tjera, sesa thjesht mohor.

Kjo e bën të krahasueshme me frëngjishten mohore *pas*, e cila edhe ajo e pat nisur karrierën si përforcuese e mohimit, pa çka se sot është gramatikalizuar.

Më në fund, është për t’u habitur që kjo *hiç* e ka gjetur rrugën drejt sistemit fjalëformues të përemrave shqip (fushë mjaft e gramatikalizuar), duke na dhënë *hiçgjë, hiçmosgjë, hiçkurrëgjë* etj.

Në Gjirokastër dëgjohet edhe *hiçnjeri* për “askush, asnjeri”.

Pyetja që duhet bërë, në këtë rast, është se si dhe pse është ruajtur kjo fjalë në shqipe, në kushtet kur ka qenë lehtësisht e zëvendësueshme nga *fare*, përkatësisht *aspak* dhe, në kontekste të tjera, nga *asgjë, asfare, kurrëgjë, mosgjë* madje edhe *zero* (khs. *pesë me hiç*) ose *jo*.

Kushedi e ka ndihmuar specializimi në ligjërimin bisedor (teksta *aspak*, bie fjala, është specializuar në ligjërimin libror; ndërsa *fare* e ka ruajtur përdorshmërinë në të gjithë regjistrat).

Por edhe një farë algjebraizimi i kuptimit, që i ka dhënë universalitet përdorimi – ose aftësia për ta shprehur mohimin [–] në mënyrë abstrakte, pa e lidhur ngushtë me ndonjë gjymtyrë të fjalisë.

Dua të them, *hiç* vërtet ka qenë e zëvendësueshme në të gjitha kontekstet ku del, por ama me fjalë të ndryshme të shqipes: *asgjë, fare, jo*. E njëjta dukuri, algjebraizimi, ndeshet – besoj – edhe në disa orientalizma të tjerë të rrënjësuar në leksik, si *qejf* dhe *zor*; kushedi ngaqë, si fjalë edhe popullore edhe abstrakte, janë përdorur para neologjizmave të hyrë në përdorim më vonë (khs. *kënaqësi, dëfrim, vështirësi*). Këtu ndoshta hyn edhe *kot*, që pas gjase nuk është orientalizëm.

Ky adoptim krijues i kësaj fjale mbase nuk ka fare të bëjë me statusin e saj prej turqizmi të rrezikuar, por vetëm rezultati fatlum i një diferencimi kuptimor të vetvetishëm. Çfarë nuk ndryshon asgjë nga fakti që *hiç* është sot nga fjalët më të përdorura në regjistrin bisedor të shqipes.

Ndryshe nga ç’ndodh në natyrë dhe gjatë proceve të seleksionit natyror, kultura priret t’i kursejë e t’i rekuperojë produktet që përndryshe seleksioni “kulturor” do t’i kish skartuar, duke i përshtatur në funksione dhe në misione të tjera. Kjo nuk vlen vetëm në produksionin gjuhësor dhe letrar, përkundrazi; mjaft të kujtoj këtu që shoqëritë kujdesen për moshat e vjetra dhe i ndihmojnë për t’i përballuar kusuret e plakjes; siç kujdesen për të sëmurët, duke shpenzuar nganjëherë energji dhe kapitale të mëdha, për t’i shëruar ose edhe për t’i lehtësuar në vuajtjet e tyre; dhe për të varfrit, që këta mund të jetojnë një jetë dinjitoze, edhe kur nuk i kanë burimet e mjaftueshme materiale.

Le t’i mendojmë pra, turqizmat, si projeksionin leksikor të një bote tashmë të lënë prapa nga historia, dhe tanimë jo ekzaktësisht reale dhe që ka ngecur në kohë; të një bote që ndoshta do të ishte më saktë ta shihnim si “shqiptari osmane” sesa si thjesht ndikimin e Perandorisë Osmane ndaj shqiptarëve, dhe që sot i ka lënë gjurmët edhe në arkitekturën e qyteteve, edhe në kulturën materiale, në kuzhinën “tradicionale” dhe deri edhe në shkallët muzikore të disa këngëve popullore sidomos qytetare. Ky projeksion meriton jo thjesht të identifikohet, por edhe të gjykohet si pjesë e identitetit tonë historik.

Një shembull nga biologjia – edhe pse jo tërësisht i goditur shkencërisht – mund të ndihmojë. Shkencëtarët sot mendojnë se rreth 8% e DNA-së njerëzore konsiston në mbetje nga viruse të lashta, ndërsa një 40% tjetër janë vargje (stringa) shkronjash gjenetike që besohet se janë me origjinë virale, pra që vijnë nga infeksione të dikurshme. Te ky shembull ka shumë gjëra që nuk shkojnë – huazimet dhe ndikimet kulturore në përgjithësi nuk janë viruse, por shpesh replikohen ngjashëm me viruset; infeksionet zakonisht janë të dëmshme për organizmin individual, ndërsa një pjesë e madhe e këtij materiali gjenetik, që i është “ngjitur” DNA-së njerëzore nga gjallesa të tjera luan rol të dobishëm në mirëmbajtjen dhe riprodhimin e jetës; megjithatë, imazhi – dhe ideja – se në kodin tonë gjenetik si specie janë trupëzuar elemente kodesh gjenetike gjallesash të tjera ndihmon për të kuptuar kontaktet mes kulturave dhe projeksionet e kulturave të ndryshme te njëra-tjetra.

Duke pasur parasysh këtë model metaforik, do ta kuptojmë më mirë si ka ndodhur, për shembull, që shqipja e sotme bisedore të ketë adoptuar një numër relativisht të madh turqizmesh, të cilat nuk kanë pasur asgjë “bisedore” në zanafillë; duke u dhënë funksione të reja; dhe jo sepse ka pasur ndonjë synim për t’i shpëtuar këta turqizma nga shuarja dhe zhdukja, por sepse i ka parë të përshtatshme për të realizuar diferencime të tilla, relativisht të sofistikuar dhe të nevojshme për një gjuhë drejt realizimit të potencialit të saj të plotë social dhe kulturor.

(c) 2026 Ardian Vehbiu. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Ilustrimi është realizuar me AI. Botohet me leje te Tema.

[2] Të vërehet se me këtë funksion “zbutës” del edhe *niente* në italishte.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Zbulimet e reja arkeologjike në Tepelenë, Rama: Po punohet për dokumentimin, pastrimin dhe konservimin e këtyre zbulimeve

09:42 Kulturë

"Muzg në kopshtin e qershive" çeli sezonin e ri në Teatrin Kombëtar

09:36 Kulturë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.